



Zyret Qendrore

Rr. Gazmend Zajmi 5 30000 Pejë-Kosovë
Telefoni: +381 (0)39 432 355

www.hidrodrini.com

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLESIT
HIDRODRINI SH.A PEJË**

PLANI I FURNIZIMIT ME UJË NË SITUATATA TE EMERGJECAVE



PËRMBAJTJA:

| | | |
|-----|---|------------------------------|
| 1. | HYRJE..... | Error! Bookmark not defined. |
| 1.1 | Qëllimi..... | Error! Bookmark not defined. |
| 1.2 | Kuadri Ligjor | 1 |
| 1.3 | Përkufizimet..... | 2 |
| 1.4 | Parimet themelore të hartimit të Planit..... | 4 |
| | a) Resurset ekzistuese..... | 4 |
| | b) Konciz dhe i qartë..... | 4 |
| | c) Koordinimi me agjencitë tjera..... | 5 |
| 1.5 | Ruajtja e Planit..... | 5 |
| 1.6 | Komponentët e Planit..... | 5 |
| 2. | FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA..... | 6 |
| 2.1 | Fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet nga to..... | 20 |
| 2.2 | Fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe rreziqet nga to..... | 20 |
| 2.3 | Veprimet luftarake dhe terrorizmi..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3. | VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË | 22 |
| 3.1 | Zona e shërbimit | Error! Bookmark not defined. |
| 3.2 | Komponentët e sistemit | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.2.1 Burimet e ujit..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.2.2 Impiantet e trajtimit të ujit dhe rezervuarët..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.2.3 Sistemi i transmisionit..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.2.4 Sistemi i shpërndarjes..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3 | Efektet e Fatkeqësisë..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.1 Mungesa e personelit..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.2 Kontaminimi i ujit | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.3 Dëmtimi i puseve dhe pompave..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.4 Prishja e gypave dhe komponentëve të gypsjellësve..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.5 Dëmtimi i objekteve..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.6 Dëmtimi i baseneve në kuadër të impiantit të trajtimit..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.7 Ndërprerja e rrymës..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.8 Ndërprerja e komunikimit..... | Error! Bookmark not defined. |
| | 3.3.9 Dëmtimi i sistemit të transportit..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4 | Komponentët kritike të sistemit..... | 29 |

| | | |
|-----|--|----|
| 4. | MASAT PARAPRAKE TË ZVOGËLIMIT/ZBUTJES SË NDIKIMIT | 38 |
| 4.1 | Mungesa e personelit..... | 38 |
| 4.2 | Masat zbutëse në burimin e ujit të papërpunuar dhe sistemin e transmisionit..... | 38 |
| 4.3 | Masat zbutëse në procesin e përpunimit të ujit..... | 38 |
| 4.4 | Rezervuarët..... | 39 |
| 4.5 | Masat zbutëse në rrejtin shpërndarës..... | 39 |
| 4.6 | Ndalimi i hyrjes në objektet e ujësjellësit për të gjithë personat e pa-autorizuar ... | 40 |
| 5. | AKTIVIZIMI I PLANIT | 41 |
| 5.1 | Skema e organizimit për menaxhim emergjent..... | 42 |
| 5.2 | Procedurat e komunikimit | 43 |
| 5.3 | Zinxhiri komandues..... | 43 |
| 6. | REAGIMI EMERGJENT DHE RIMËKËMBJA..... | 45 |
| 6.1 | Hapi 1: Analizimi i llojit dhe ashpërsisë së incidentit..... | 45 |
| 6.2 | Hapi 2: Ofrimi i ndihmës emergjente për shpëtimin e jetëve | 46 |
| 6.3 | Hapi 3: Ndërmarrja e riparimeve emergjente bayuar në kërkesat prioritare..... | 46 |
| 6.4 | Hapi 4: Rimëkëmbja e sistemit..... | 46 |
| 6.5 | Hapi 5: Nxjerrja e mësimave dhe vlerësimi i planit..... | 46 |
| 6.6 | Hapi 6: Rishikimi i Planit sipas nevojës | 46 |
| 6.7 | Hapi 7: Trajnimi..... | 46 |
| | Shtojca 1: Harta e Zonës së Shërbimit të KRU | 48 |
| | Shtojca 2: Harta e objekteve vitale të sistemit në qytetin e..... | 49 |
| | Shtojca 3: Harta e objekteve vitale të sistemit në qytetin e..... | 50 |
| | Shtojca 4: Harta e objekteve vitale të sistemit në qytetin e..... | 51 |
| | Shtojca 5: Harta sizmike e Kosovës..... | 52 |
| | Shtojca 6: Harta e zonave vërshyese të Kosovës..... | 53 |
| | Shtojca 7: Shembuj të urdhërave për mospërdorim dhe vlim të ujit..... | 54 |

SHKURTESAT

| | |
|--------|---|
| AME | Agjencia e Menaxhimit Emergjent |
| ARRU | Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit |
| IKSHPK | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës |
| IHMK | Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës |
| KRU | Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit |
| PRE | Plani i Reagimit Emergjent |
| QOE | Qendra e Operative Emergjente |

1. Hyrje

- 1.1 Qëllimi

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është që të shërbejë kompaninë KUR HIDRODRINI, si si duhet vepruar në rastet emergjente, ku si pasoje rrezikohet furnizimi i rregullt me ujë dhe rrezikojnë cilësinë e furnizimit me ujë

- 1.2 Kuadri Ligjor

Disa prej ligjeve dhe akteve nënligjore për menaxhimin e emergjencave janë dhënë në vijim:

- Ligji Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit
Neni 48 përcakton obligimin e KRU-ve që të hartojnë planin e furnizimit me ujë në situata të emergjencave të cilat plane duhet të miratohen nga Autoriteti për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit-ARRU).
- Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
Ky ligj përcakton sistemin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera i cili përmban programimin, planifikimin, organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera
- Rregullore Nr. 08/2013 për Përbajtjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent.
Neni 22, 23, dhe 24 përcakton përbajtjen e planeve të reagimit emergjent si dhe shtojcave të nevojshme që duhet të përmbajnë këto plane.
- Rregullore Nr. 28/2012 Për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
Neni 3 përcakton që vlerësimi i rrezikshmërisë është dokumenti bazë për hartimin e planeve, planeve operative dhe planeve të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, të cilin janë të obliguar ta hartojnë "...personat juridik, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me objektet e infrastrukturës kritike, përkatësisht objekteve të rëndësishme të veçantë..."
- Udhëzimi Administrativ nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum nga Njeriu.

Ky akt përcakton përgjegjësinë e autoriteti shëndetësor (d.m.th. Qendra e Ujit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike) për marrjen e vendimit për kufizimin apo ndalimin të përdorimit të ujit nga sistemi i ujësjellësit kur uji nuk i përmbush vlerat parametrike të përcaktuara me këtë Udhëzim.

- **1.3 Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimet si vijon:

'Emergjencë' – çdo ndodhi për të cilën nevojitet asistencë nga niveli i pushtetit qendror për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e aseteve dhe shëndetit publik ose për shmangien e rrezikut nga katastrofat në cilëndo pjesë të Republikës së Kosovës.

'Fatkeqësi' – një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta.

'Fatkeqësi natyrore' – janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët e borës, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësia, zjarri fushor, shpërthimi i sëmundjeve infektive që rrezikojnë furnizimin me ujë.

'Fatkeqësi tjera' – janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë.

'Gatishmëri' - aktivitete efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, të cilat fillojnë me një mori aktiviteteve përgatitore, të kryera në vijimësi shumë herët para çdo incidenti të mundshëm. Gatishmëria përfshinë një kombinim të integruar të vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve dhe ushtrimeve, kualifikimit, licencimit dhe certifikimit të personelit, si dhe certifikimit, vlerësimit dhe inspektimit të pajisjeve.

'Incident' - një ndodhi natyrore ose e shkaktuar nga faktori njeri e cila kërkon një reagim emergjent për mbrojtjen e komponentëve të sistemit dhe për sigurimin e cilësisë së ujit në pjetim me standardet. Në incidente mund të përfshihen: fatkeqësitë e mëdha, emergjencat, sulmet terroriste, zjarret urbane dhe malore, vërshimet, rrjedhjet e materieve të rrezikshme, aksidentet nukleare, aksidentet ajrore, tërmetet, shtrëngatat, fatkeqësitë e lidhura me luftën, emergjencat e shëndetit publik dhe ndodhit tjera që kërkojnë reagim emergjent.

'Infrastruktura kritike' – sisteme dhe asete (fizike apo virtuale) jetike për Republikën e Kosovës mosfunksionimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishin efekt të edëmshëm në siguri kombëtare, siguri ekonomike, shëndet apo siguri publike apo në kombinimin e cilës do prej tyre.

'Kërcënim' - ekspozimi real dhe i menjëhershëm i komponentëve të sistemit të furnizimit me ujë dhe cilësisë së ujit ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

'Komandanti i Incidentit' – person përgjegjës për të gjitha aktivitetet në incident, përfshirë zhvillimin e strategjive dhe taktikave si dhe porositjen dhe lirin e resurseve që ka përgjegjësinë dhe autoritetin e plotë për zhvillimin e operacioneve në incident dhe është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes.

'Masë parandaluese' - çdo masë e ndërmarr për parandalimin e ndodhjes së fatkeqësisë ose për lehtësimin e pasojave të dëmshme të saj.

'Materie e rrezikshme' - çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve. Në materie të rrezikshme hyjnë helmet, kancerogjenet, kaustikët, oksidet dhe ngacmuesit (irrituesit), radioaktivët, infektuesit, eksploduesit, materiet ndezëse ose materiet që shkaktojnë ndezje në kontakt me substanca tjera.

'Paralajmërim' - procedurat dhe aktivitetet për njoftimin e popullatës, komunitetit lokal, autoriteteve kombëtare për rrezikun real ose potencial nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër.

'Parandalim' - veprime të ndërmarra për shmangien e një incidenti apo ndërhyrje për ta penguar ndodhjen e tij. Parandalimi përfshin: (i) veprimet e ndërmarra për mbrojtjen e jetës dhe të mirave materiale, (ii) aplikimin e informacioneve të zakonshme dhe inteligjente në morinë e aktiviteteve të cilat mund të përfshijnë kundërmasat si operacionet e përmbajtjes; inspektimet e shtuara; operacionet e sigurisë dhe mbikëqyrjes së përmirësuar; hetimet për përcaktimin e natyrës dhe burimit të kërcënimit; mbikëqyrjen e shëndetin publik dhe bujqësor dhe proceset e testimi; imunizimet, izolimet apo karantinën; dhe sipas nevojës, operacionet e veçanta të zbatimit të ligjit të destinuara për pengimin, kapjen, ndalimin apo çrregullimin e aktiviteteve ilegale dhe kapjen e autorëve të mundshëm kriminal dhe dërgimin e tyre para organeve të drejtësisë.

'Përfaqësues i agjencisë' – person i caktuar nga agjencia qeveritare e nivelit lokal, regjional apo qendror ose entiteti privat të cilit i është deleguar autoriteti për të marr vendime (duke ndjekur konsultimet e nevojshme me lidërsipin), në emër të agjencisë pjesëmarrëse në aktivitetet e menaxhimit të incidentit.

'Plani i Reagimit Emergjent' - plan i hartuar dhe i mirëmbajtur për menaxhimin e rreziqeve të ndryshme të mundshme.

'Plani i veprimit për menaxhimin e incidentit' - një plan gojor apo i shkruar i cili përmban në vete objektivat e përgjithshme, të cilat reflektojnë strategjinë e përgjithshme për menaxhimin e incidentit. Mund të përfshijë përcaktimin e detyrave dhe resurseve operative. Gjithashtu mund të përfshijë shtojcat të cilat ofrojnë drejtim dhe informacione të rëndësishme për menaxhimin e incidentit, gjatë një apo më shumë periudhave operative.

'Qendra Operative Emergjente' – lokacion fizik në të cilin zhvillohet koordinimi i informacioneve dhe resurseve për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit. informacioneve dhe resurseve për mbështetjen e aktiviteteve të menaxhimit të incidentit.

'Reagim Emergjent' – aktivitetet të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit të goditur.

'Vlerësimi i rrezikut' - analizat cilësore dhe sasore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimit të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

'Zbutja' – aktivitete të destinuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve ndaj personave apo të mirave materiale apo për zvogëlimin e efekteve, pasojave aktuale ose të mundshme të një incidenti..

- 1.4 Parimet themelore të hartimit të Planit

Edhe përkundër vlerësimit të rrezikshmërisë dhe ndërmarrjes së masave paraprake për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të fatkeqësive, mund të ndodhin fatkeqësi të përmasave dhe shtrirjes që dëmtojnë komponentët e sistemit dhe rrjedhimisht kërcënojnë funksionimin normal të sistemit të furnizimit me ujë.

Parimet bazë të hartimit të Planit të Reagimit Emergjent:

- a) Të shfrytëzohen resurset ekzistuese
- b) Të jetë konciz dhe i qartë
- c) Të jetë i koordinuar me agjencitë tjera.

a) Resurset ekzistuese

Plani duhet të bazohet në gjendjen ekzistuese të sistemit dhe komponentëve të sistemit e jo në masat zbutëse të cilat planifikohen e që nuk janë zbatuar ende.

b) Konciz dhe i qartë

Terminologjia dhe fjalët e përdorura në plan duhet të jenë të kuptueshme për personelin i cili duhet ta zbatojë planin.

c) Koordinimi me agjencitë tjera

Për zbatimin efektiv të planit është i nevojshëm bashkëpunimi dhe koordinimi me agjencitë tjera. Për shembull sistemet e furnizimit me ujë janë të varura nga furnizimi me rrymë elektrike, sistemet e telekomunikimit, infrastrukturën transportuese etj. Në anën tjetër, resurset e KRU-së duhet të ndihmojnë shërbimeve tjera publike dhe strukturave të menaxhimit të emergjencave.

- **1.5 Ruajtja e Planit**

Një kopje e Planit ruhet në ndërtesën e administratës së Kompanisë, nga një kopje në impiantet e trajtimit, dhe një kopje në Agjencinë e menaxhimit Emergjent.

- **1.6 Komponentët e Planit**

Plani i menaxhimit emergjent duhet ti ketë komponentët si vijon:

1. Përshkrimin e zonës së shërbimit si dhe komponentëve kryesore të sistemit të furnizimit me ujë;
2. Hartën me elementet e sistemit të ujësjellësit si: objektet e kaptimit dhe impiantet e trajtimit të ujit, stacionet e pompimit, rrjetin shpërndarës të ujësjellësit përfshirë valvulat etj.
3. Përshkrimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe vlerësimin e rrezikshmërisë për komponentët e sistemit të furnizimit me ujë nga këto fatkeqësi.
4. Procedurat e aktivizimit të Planit.
5. Lista me detajet kontaktuese të shërbimeve emergjente, AME, ARRU, kontraktorëve, konsumatorëve special (spitalet, policia etj.), mediave dhe KRU-ve tjera.
6. Përcaktimin se kush i operon pjesët kritike të sistemit në rast të mungesës së personelit.
7. Përshkrimin e mënyrës për marrjen e ujit nga burimet alternative nëse paraqitet nevoja.
8. Përshkrimi i metodave të njoftimit të konsumatorëve për situatat emergjente dhe për këshillimin e tyre për veprimet në këto situata.

2. Sistemi i Furnizimit me Ujë

- 2.1 Zona e shërbimit

KRU "HIDRODRINI", sh.a. në Pejë, është përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm për komunat e Pejës, Istogut, Klinës, Deçanit dhe Junikut.

Tabela në vijim paraqet detaje të komunave që furnizohen me ujë nga KRU "Hidrodrini" së bashku me të dhënat mbi numrin e konsumatorëve për secilën komunë me numrin e popullsisë përkatëse.

- Tabela 1. Komunat që furnizohen me ujë nga KRU HIDRODRINI

| Komuna | Nr. i konsumatoreve | Nr. i popullsisë |
|--------|---------------------|------------------|
| Peja | 25.919 | 120000 |
| Istogu | 8.612 | 31.484 |
| Klina | 4.619 | 15.836 |
| Decani | 5.933 | 21.748 |
| Juniku | 1.328 | 13,000 |
| Totali | 46.411 | 165.068 |

- 2.2 Komponentët e sistemit

2.2.1 Burimet e ujit në zonën e shërbimit të KRU "Hidrodrini"

Në këtë pjesë janë të përshkruara të gjitha burimet e ujit që gjenden në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini, prej nga ofrohen edhe detaje specifike që i karakterizojnë këto burime.

Burimet e ujit në komunën e Pejës

- Burimi i Ujit të zi

Është burim nëntokësorë i cili gjendet në pjesën e rrugës nga qyteti i Pejës në drejtim të zonës së Rugovës. Kapaciteti i burimit është 308 l/s, ky burim kaptohet përmes galerisë dhe nuk ka nevojë për asnjë trajtim përveç klorinimit. Pastaj uji me gravitet vazhdon deri tek dy stacionet e pompimit si dhe një pjesë e cila furnizon disa zona të qytetit me gravitet. Njëri nga stacionet e pompimit pompon ujin në rezervar kurse tjetri stacion e bën shtytjen e ujit direkt për qytet.

- Burimi i Drinit të Bardh

Është burim nëntokësorë dhe gjendet në fshatin Radavc. Ky burim kaptohet përmes një kaptazhë dhe kapaciteti i tij është 295 l/s. E gjithë sasia e ujit rrjedh me gravitet, ku furnizon një pjesë të qytetit të Pejës, shumë fshatra të komunës së Pejës dhe disa fshatra të komunës së Istogut. Edhe uji i këtij burim po ashtu nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër pos klorinimit i cili kryhet disa metra poshtë burimit.

Në figurën 1 më poshtë është paraqitur në formë skematike sistemi i ujësjellësit që furnizon qytetin e Pejës me komponentët kryesore të tij.





Figura 2: Skema e sistemit të furnizimit me ujë të Pejës

Burimet e ujit në komunën e Klinës

- Burimi i Jarinës

Është burim nëntokësore me kapacitet prej 300 l/s. E gjithë sasia e ujit rrjedh me gravitet deri tek stacionet e pompimit, ku nga aty përmes pompave uji një pjesë furnizon pjesën veriore të Klinës dhe një pjesë tjetër disa fshatra.




Burimet e ujit në komunën e Istogut

- Burimi Istogut

Është burim nëntokësore dhe ndodhet në qytetin e Istogut. E gjithë sasia e ujit rrjedh me gravitet, ku furnizon qytetin e Istogut dhe shume fshatra të komunës së Istogut. Uji i këtij burim po ashtu nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër pos klorinimit i cili kryhet po aty.

- Burimi i Vrellës

Është burim nëntokësorë dhe ndodhet mbi fshatin Vrellë afër bjeshkëve. E gjithë sasia e ujit rrjedh me gravitet, ku furnizon fshatin Vrellë dhe disa fshatra përreth. Uji i këtij burimi po ashtu nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër pos klorinimit i cili tani për tani është jashtë funksionit.



Burimet e ujit në komunën e Deçanit

Qyteti i Deçanit furnizohet nga disa burime të cilat gjenden në bjeshkët e Deçanit

- Burimi i Deçanit

Burimet bashkohen në një gyp të vetëm dhe me gravitet vijnë deri tek pjesa e ashtuquajtur Podi i Gështenjave ku edhe ndodhet rezervari me vëllim prej 580 m³.

Nga ajo pikë po me gravitet uji shpërndahet dhe furnizon qytetin e Deçanit dhe disa fshatra

Ky ujë nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër përveç që klorinohet dhe klorinatori gjendet afër rezervarit.

- Burimi i CDF – it

Është një burim i cili furnizon 6 fshatra, uji shkon me gravitet. Ky burim ka rezervar 600 m³, po ashtu edhe klorinator. Ky ujë nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër përveç që klorinohet dhe klorinatori gjendet afër rezervarit.

- Burimi i Isniqit

Është një burim i cili furnizon fshatin Isniq, uji shkon me gravitet. Ky burim ka rezervar 700 m³, po ashtu edhe klorinator. Ky ujë nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër përveç që klorinohet dhe klorinatori gjendet afër rezervuarit.

Burimet e ujit në komunën e Junikut

- Burimi - Livadhi i madh

Ka një kapacitet prej 20 - 40 l/s, i cili buron nga bjeshkët e Junikut për të cilin nevojitet vetëm të bëhet klorinimi. Burimi i Livadhit të madh bashkohet me Burimin e Goçit dhe uji pastaj shkon në rezervuarin e qytetit me kapacitet prej 500 m³. Klorinimi i ujit bëhet në rezervuar.

- Burimi i Goçit

Janë dy burime nëntokësore të cilat burojnë në bjeshkët e Junikut, dikund rruges behen bashkë dhe vazhdojnë rrugën deri në rezervar 500 m³, dhe kanë një kapacitet prej 14-36 l/s.

Ky ujë nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër përveç që klorinohet dhe klorinatori gjendet afër rezervarit, ku pastaj me gravitet furnizon qytetin e Junikut

- Burimi i Shkozës

Është një burim i cili furnizon disa lagje të Junikut dhe disa fshatra me një kapacitet prej 20-64 l/s. Nga burimi ky ujë vazhdon përmes gypit AC 400 mm me gravitet deri tek rezervari 500 m³ dhe nuk ka nevojë për asnjë trajtim tjetër përveç që klorinohet dhe klorinatori gjendet afër rezervarit, ku pastaj bëhet furnizimi i disa lagjeve të Junikut dhe disa fshatrave.

Tabela në vijim paraqet të gjitha burimet në KRU "Hidridrini", ku disa prej tyre janë burime të cilat nuk menaxhohen momentalisht e që priten që në një të ardhme të futen nën menaxhim.

| Nr | Emri i objektit | X | Y | Z | Komuna | Vëllimi/Kapaciteti m ³ | Lloji i burimit/rezervuarit |
|----|-------------------------|--------------|--------------|----------|--------|-----------------------------------|-----------------------------|
| 1 | Burimi Uji Zi | 7,439,089.76 | 4,725,019.21 | 542.00 | Pejë | 308 l/s | Burim malor |
| 2 | Burimi Uji Bardhë | 7,439,004.52 | 4,724,878.97 | 542.50 | Pejë | 50 l/s | Burim malor |
| 3 | Burimi Drini Bardhë | 7,443,189.89 | 4,733,387.59 | 564.20 | Pejë | 295 l/s | Burim malor |
| 4 | Burimi Istogut | 7,457,551.25 | 4,738,925.91 | 516.99 | Istog | 312 l/s | Burim malor |
| 5 | Burimi Istog | 7,457,596.45 | 4,738,953.28 | 534.61 | Istog | 312 l/s | Burim malor |
| 6 | Burimi Javor 1 | 7,466,205.25 | 4,746,684.18 | 1,434.21 | Istog | 1 l/s | Burim malor |
| 7 | Burimi Javor 2 | 7,466,678.09 | 4,746,406.66 | 1,283.38 | Istog | 1 l/s | Burim malor |
| 8 | Burimi Vrellë | 7,450,853.44 | 4,737,414.95 | 551.92 | Istog | 82 l/s | Burim malor |
| 9 | Burimi Vojdullë 3 | 7,465,298.89 | 4,747,590.59 | 1,271.11 | Istog | 5.7 l/s | Burim malor |
| 10 | Burimi Vojdullë 2 | 7,465,409.89 | 4,747,847.59 | 1,292.58 | Istog | 5.7 l/s | Burim malor |
| 11 | Burimi Vojdullë 1 | 7,465,216.89 | 4,748,202.59 | 1,341.78 | Istog | 5.7 l/s | Burim malor |
| 12 | Burimi Kosharishtë 2 | 7,462,786.89 | 4,745,996.59 | 1,438.53 | Istog | 5.7 l/s | Burim malor |
| 13 | Burimi Kosharishtë 1 | 7,463,512.89 | 4,746,433.59 | 1,378.56 | Istog | 5.7 l/s | Burim malor |
| 14 | Burimi Shkozë | 7,441,031.22 | 4,706,464.34 | 544.50 | Junik | 20 - 64 l/s | Burim malor |
| 15 | Burimi Lipovicë | 7,439,097.98 | 4,705,332.17 | 650.50 | Junik | 6 - 14 l/s | Burim malor |
| 16 | Burimi Goç | 7,435,978.41 | 4,704,868.35 | 1,225.50 | Junik | 14 - 36 l/s | Burim malor |
| 17 | Burimi Jarina | 7,467,768.76 | 4,720,278.83 | 420.00 | Klinë | 300 l/s | Burim malor |
| 18 | Burimi Fabrika e Re | 7,464,748.10 | 4,720,334.85 | 378.00 | Klinë | 100 l/s | Puse nëntok |
| 19 | Burimi Garabili | 7,467,854.54 | 4,709,391.22 | 460.00 | Klinë | 45 l/s | Burim malor |
| 20 | Burimi Kpuz | 7,461,232.49 | 4,710,988.29 | 375.00 | Klinë | 10 l/s | Puse nëntok |
| 21 | Burimi Dullov - Rastoka | 7,463,928.59 | 4,713,202.01 | 362.00 | Klinë | 7 l/s | Puse nëntok |
| 22 | Burimi Berkov | 7,461,433.40 | 4,726,128.69 | 404.00 | Klinë | 8 l/s | Puse nëntok |
| 23 | Burimi 1 | 7,435,876.72 | 4,712,632.30 | 766.01 | Deçan | 30 l/s | Burim malor |
| 24 | Burimi 2 | 7,435,471.02 | 4,712,852.20 | 780.98 | Deçan | 32 l/s | Burim malor |
| 25 | Burimi 3 | 7,434,467.72 | 4,712,765.70 | 1,020.83 | Deçan | 28 l/s | Burim malor |

2.2.2 *Sistemi i transmisionit*

a) **Gypi transportues nga burimi i Drinit të Bardhë deri në Qytetin e Pejës**

Fillimi i këtij gypi është në kaptazhën e burimit të drinit të bardhë me një diametër prej Ø 600 mm dhe me material të Azbest Cimentos AC. Përgjatë rrugës së tij për të furnizuar qytetin e Pejës, diametri këtij gypi zvogëlohet në Ø 500 mm. Nga burimi i i Drinit të Bardhë deri në qytetin e Pejës, uji vjen me rënie të lirë.

b) **Gypi transportues nga burimi i ujit të zi deri në Qytetin e Pejës**

Edhe ky gyp është nga materiali i Azbest Cimentos- AC dhe me diametër prej Ø 500 mm. Gypi starton prej burimit të ujit të zi dhe me rënie të lirë deri tek objektet administrative të kompanisë Hidrodrini, ku pastaj një pjesë përmes pompave dërgohet në zonën urbane të qytetit, dega tjetër përmes pompave furnizon rezervuarin qytetit për të mundësuar furnizimin me ujë në pikat më të larta të qytetit, kurse dega tjetër me anë të gravitetit furnizon pjesën e mbetur të qytetit.




Figura 2: Rrjeti distributiv i furnizimit me ujë për qytetin e Pejës.



Figura: Skema e rrjetit ne qytetin e Istogut



Figura : Skema e rrjetit ne qytetin e Klines

2.2.3 Rezervuarët

KRU "Hidrodrini" ka në operim një mori të rezervuarëve në tërë zonën e saj të shërbimit. Këta rezervuarë kryesisht janë të ndërtuar nga materiali beton-arme, në të shumtën e raste ata kanë formë drejtkëndëshe dhe një pjesë e tyre kanë formë rrethore.

| Nr | Emri I rezervuarit | X | Y | Z | Vellimi_m3 | Lloji | Materiali |
|----|-------------------------|--------------|--------------|--------|------------|-------------|-----------|
| 1 | Tank II Jabllanicë | 7,444,625.42 | 4,734,537.49 | 552.92 | n/a | Drejtëndësh | Beton |
| 2 | Tank I Jabllanicë | 7,443,598.33 | 4,733,652.73 | 629.10 | n/a | Drejtëndësh | Beton |
| 3 | Rezervuari I | 7,439,346.72 | 4,724,969.59 | 579.00 | 1,500 | Drejtëndësh | Beton |
| 4 | Rezervuari II | 7,440,162.26 | 4,725,176.85 | 587.50 | 3,000 | Drejtëndësh | Beton |
| 5 | Rezevuari II | 7,458,102.46 | 4,738,927.14 | 588.51 | 1,000 | Rrethor | Beton |
| 6 | Rezervuari I | 7,458,123.17 | 4,738,607.62 | 510.42 | 600 | Rrethor | Beton |
| 7 | Rezervuari Zhakovë | 7,466,343.71 | 4,742,071.94 | 701.32 | 400 | Drejtëndësh | Beton |
| 8 | Rezervuari Studenicë | 7,449,740.83 | 4,736,822.09 | 593.36 | 700 | Rrethor | Beton |
| 9 | Rezervuari Shushicë | 7,465,020.23 | 4,741,576.65 | 704.39 | 400 | Drejtëndësh | Beton |
| 10 | Rezervuari Osojan | 7,463,586.02 | 4,730,201.72 | 549.50 | 300 | Drejtëndësh | Beton |
| 11 | Rezervuari Cercë | 7,457,200.29 | 4,738,647.15 | 575.03 | 400 | Drejtëndësh | Beton |
| 12 | Rezervuari Junik | 7,439,787.51 | 4,705,193.73 | 616.50 | 500 | Rrethor | Beton |
| 13 | Rezervuari i ri | 7,442,892.15 | 4,704,681.89 | 509.50 | 35 | Drejtëndësh | Beton |
| 14 | Rezervuari Tikvesh 1 | 7,465,443.43 | 4,720,721.79 | 444.00 | 1,000 | Rez. Nëntok | Beton |
| 15 | Rezervuari Tikvesh 2 | 7,465,424.51 | 4,720,698.72 | 441.00 | 500 | Rez. Nëntok | Beton |
| 16 | Rezervuari Pograxh | 7,467,755.66 | 4,720,293.07 | 542.00 | 800 | Rez. Nëntok | Beton |
| 17 | Rezervuari Kpuz | 7,460,988.23 | 4,712,847.91 | 470.00 | 180 | Rez. Nëntok | Beton |
| 18 | Rezervuari Dollove | 7,463,813.29 | 4,713,658.24 | 606.00 | 180 | Rez. Nëntok | Beton |
| 19 | Rezervuari Sferk | 7,468,072.53 | 4,713,242.38 | 640.00 | 400 | Rez. Nëntok | Beton |
| 20 | Rezervuari Jashanic | 7,468,077.30 | 4,713,251.35 | 557.00 | 200 | Rez. Nëntok | Beton |
| 21 | Rezervuari Berkove | 7,461,930.00 | 4,726,845.33 | 499.00 | 180 | Rez. Nëntok | Beton |
| 22 | Rezervuari Videje | 7,462,281.77 | 4,720,468.55 | 433.00 | 200 | Rez. Nëntok | Beton |
| 23 | Rezervuari Fabrika e Re | 7,464,748.10 | 4,720,334.85 | 378.00 | 500 | Rez. Nëntok | Beton |
| 24 | Rezervuari Jarine | 7,465,440.32 | 4,720,693.34 | 388.00 | 50 | Rez. Nëntok | Beton |
| 25 | Rezervuari Siqeve | 7,474,993.28 | 4,722,264.44 | 868.00 | 180 | Rez. Nëntok | Beton |
| 26 | Rezervuari 1 | 7,439,759.62 | 4,710,668.70 | 704.90 | 202 | Drejtëndësh | Beton |
| 27 | Rezervuari 2 | 7,439,759.62 | 4,710,668.70 | 704.90 | 202 | Drejtëndësh | Beton |

2.2.3 Stacionet e pompimit

Në shumicën burimeve ujore uji nga burimi deri në pika të caktuara shkon me gravitet, ku pastaj përmes stacioneve të pompave uji dërgohet në rezervuare të ndryshme, kurse një pjesë tjetër përmes pompave ujit u dërgohet direkt konsumatorëve. Vlen të theksohet se njësia e Decanit dhe e Junikut nuk përdorin stacione të pompimit, uji në këto njësi dërgohet tek konsumatorët me anë të rënies së lirë.

| Nr. | Emri i objektit | X | Y | Z | Komuna | Numri i pompave ne stacion | Fuqia e pompave dhe kapaciteti |
|-----|-----------------------------------|--------------|--------------|--------|--------|----------------------------|---|
| 1 | Stacioni i vjetër i pompave | 7,440,153.35 | 4,724,900.73 | 534.00 | Pejë | 4 | P = 525 kw Q = 3,123 m ³ /h |
| 2 | Stacioni i pompave të reja | 7,440,136.44 | 4,724,898.30 | 534.00 | Pejë | 3 | P = 480 kw Q = 1,633 m ³ /h |
| 3 | SP 7 Shtatori | 7,443,166.27 | 4,726,173.96 | 524.00 | Pejë | 1 | P = 3 kw Q = 7.9 m ³ /h |
| 4 | SP rruga e Batonëve | 7,442,756.94 | 4,725,755.55 | 520.50 | Pejë | 1 | P = 7.5 kw |
| 5 | SP te Havollt | 7,442,796.35 | 4,725,812.72 | 522.50 | Pejë | 1 | P = 8 kw Q = 10.8 m ³ /h |
| 6 | SP rruga Ilaz Pashë Dibra | 7,442,589.53 | 4,726,062.38 | 569.00 | Pejë | 1 | P = 2.5 kw |
| 7 | SP rruga Tasim dhe Hajrush Elezaj | 7,442,953.38 | 4,725,955.13 | 523.00 | Pejë | 1 | P = 8 kw Q = 10.8 m ³ /h |
| 8 | SP Asllan Qeshme | 7,441,483.23 | 4,725,344.97 | 525.00 | Pejë | 1 | P = 10.2 kw Q = 28.1 m ³ /h |
| 9 | SP Zatra | 7,441,616.20 | 4,724,100.09 | 530.00 | Pejë | 1 | P = 30 kw Q = 59.4 m ³ /h |
| 10 | SP Zahaq | 7,450,681.01 | 4,724,066.00 | 460.50 | Pejë | 2 | P = 11 kw Q = 24 m ³ /h |

| | | | | | | | |
|----|-----------------|--------------|--------------|--------|-------|----|---|
| 11 | SP Bellopojë | 7,441,803.13 | 4,722,897.11 | 534.50 | Pejë | 1 | P = 22 kw Q = 42 m ³ /h |
| 12 | SP Brestovik | 7,443,942.00 | 4,729,684.38 | 539.70 | Pejë | 1 | P = 5.7 kw Q = 5.4 m ³ /h |
| 13 | SP Istog | 7,458,148.91 | 4,738,555.55 | 506.69 | Istog | 2 | P = 110 kw |
| 14 | SP Cerrce | 7,457,368.29 | 4,738,379.08 | 505.14 | Istog | 2 | P = 35 kw |
| 15 | SP Studenice | 7,450,388.02 | 4,736,599.24 | 510.57 | Istog | 2 | P = 75 kw |
| 16 | SP Dubrave | 7,461,129.63 | 4,737,963.37 | 506.20 | Istog | 2 | P = 38 kw |
| 17 | | 7,462,830.38 | 4,731,029.74 | 438.00 | Istog | 2 | P = 22 kw |
| 18 | SP Jarina | 7,465,440.32 | 4,720,693.34 | 388.00 | Klinë | 3 | P = 225 kw Q = 172.8 m ³ /h |
| 19 | SP Fabrika e Re | 7,464,748.10 | 4,720,334.85 | 378.00 | Klinë | 10 | P = 513 kw Q = 288 m ³ /h |
| 20 | SP Kpuz | 7,461,232.49 | 4,710,988.29 | 375.00 | Klinë | 1 | P = 18.5 kw Q = 28.8 m ³ /h |
| 21 | SP Jashanic | 7,469,841.02 | 4,723,606.68 | 745.00 | Klinë | 1 | P = 7.5 kw Q = 18 m ³ /h |
| 22 | SP Dullov | 7,463,935.42 | 4,713,202.60 | 362.00 | Klinë | 1 | P = 15 kw Q = 21.6 m ³ /h |
| 23 | SP Berkov | 7,461,433.40 | 4,726,128.69 | 404.00 | Klinë | 1 | P = 11 kw Q = 14.4 m ³ /h |
| 24 | SP Siqev | 7,473,226.00 | 4,720,401.04 | 560.00 | Klinë | 1 | P = 18.5 kw Q = 21.6 m ³ /h |

3. Vlerësimi i rrezikshmërisë

3.1. FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

3.1.1 Fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet nga to

- **Tërmetet** mund të shkaktojnë dëme të rënda dhe të shumta edhe në komponentët e sistemit të ujësjellësit, dëme këto që varen shkalla e tërmetit, lloji i tokës, projektimi dhe materialet e objekteve etj.
- **Përmbytjet** mund të shkaktohen nga reshjet intensive, shkrirja e borës apo prishja e digës. Dëmet që mund të shkaktojnë përmbytjet në sistemet e furnizimit me ujë përfshijnë: kontaminimin e ujit, përmbytjen e impianteve të trajtimit të ujit dhe stacioneve të pompimit, ndërprerja e rrymës elektrike, transportimit dhe komunikimit.
- **Kushtet tjera ekstreme atmosferike** si temperaturat ekstreme të ulëta dhe të larta, bora e madhe, shtërngatat, erërat e fuqishme, rrëshqitjes së dheut dhe dëborës etj. mund të kenë ndikim afatshkurtër ose afatgjatë në furnizim me ujë. Kështu bora e madhe shkakton vështirësi në qarkullimin e personelit të Kompanisë, mbulimin e valvulave dhe komponentëve tjera të sistemit. Moti i ftohtë mund të shkaktojë ngrirjen e valvulave, gypave dhe ujit në rezervuar. Moti i nxehtë mund të rezultojë me thatësi dhe reduktim të kapaciteteve të burimeve.

3.1.2 Fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe rreziqet nga to

- **Aksidentet transportuese** mund t'i dëmtojnë komponentët mbitokësore të sistemit dhe t'i pengojnë vijat e qarkullimit dhe komunikimit, dhe rrjedhimisht duhet të merren parasysh në planifikimin emergjent.
- **Derdhja e materieve të rrezikshme**, mund të ketë efekt serioz në kontaminimin e ujit prandaj duhet të ndërmerren masa për parandalimin e depërtimit të këtyre materieve në sistemin e furnizimit me ujë si dhe për minimizimin e shpërhaqjes së këtij kontaminimi nëpër pjesët e sistemit.
- **Zjarri** në impiantin e trajtimit të ujit apo në stacionet e pompimit mund ta çrregullojë dhe kërcënojë në masë të madhe furnizimin me ujë dhe t'i shkatërrojë pajisjet kompjuterike dhe kontrolluese. Gjithashtu, zjarri mund t'i dëmtojë zyrat dhe depot e Kompanisë.
- **Aktet vandaliste dhe trazirat** mund të rezultojnë me rrezikimin dhe dëmtimin e pjesëve kritike të sistemit të furnizimit me ujë si, stacionet e pompimit, impiantet, digat, hidrantët etj. si dhe kontaminimin e ujit dhe prandaj duhet të merren në konsideratë në planet e menaxhimit të incidenteve si rreziqe potenciale.

- Veprimet luftarake dhe terrorizmi

Gjithashtu mund të kenë efekte kritike në sistemin e furnizimit me ujë dhe rrjedhimisht duhet të trajtohen me planin e reagimit emergjent.

- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së fatkeqësive

Vlerësimi i probabilitetit të ndodhjes së fatkeqësive të cilat mund ta afektojnë sistemin e ujësjellësit është bazuar në informacionet e disponueshme që posedon KRU Hidromorava si dhe ato të siguruar nga institucionet relevante.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë një përmbledhje e fatkeqësive të mundshme dhe shkallës së vlerësuar.

Mundësia e ndodhjes klasifikohet si vijon:

| Shkalla e mundësisë (m) | Karakteristikat |
|-------------------------|---|
| shumë e mundshme (4) | mundësia e ndodhjes gati 100% në vitin e ardhshëm |
| e mundshme (3) | mundësia e ndodhjes 10% vitin e ardhshëm ose 1 herë në 10 vitet e ardhshme |
| ka gjasa (2) | mundësia e ndodhjes 1% në vitin e ardhshëm ose 1 herë në 100 vitet e ardhshme |
| e pamundshme (1) | mundësia e ndodhjes më e vogël se 1% në vitin e ardhshëm |

Tabela 4: Përmbledhje e fatkeqësive të mundshme dhe shkallës së rrezikshmërisë

| Lloji i fatkeqësisë | Mundësia e ndodhjes | Magnituda | Vërejtje |
|------------------------------|---------------------|-----------|---------------------------------|
| Tërmeti | Ka gjasa | | Nuk ka sistem të paralajmerimit |
| Përmytjet | E mundshme | | p.sh. FPU Klinë |
| Kushtet ekstreme atmosferike | E mundshme | 20 m/s | |

| | | | |
|-----------------------------------|------------|--|--|
| Derdhja e materieve te rrezikshme | Ka gjasa | | Edhe pse shumica e burimeve janë larg rruge, megjithatë duhet pasur kujdes ne pika te caktuara |
| Zjarret | E mundshme | | Objektet Administrative, FPU - Kline |
| Aktet vandaliste | Ka gjasa | | Rezervuarët, hidrantët, stacionet e klorinimit. |
| Trazirat | Ka gjasa | | Objektet Administrative, FPU - Kline |
| Aktet terroriste | Ka gjasa | | Rezervuaret dhe burimet |

3.3 Efektet e Fatkeqësisë

3.3.1 Mungesa e personelit

Komponenti më kritik i një sistemi të furnizimit me ujë është personeli i trajnuar i operativës. Një fatkeqësi mund të shkaktojë mungesë të personelit për shkaqe të vdekjes, lëndimit etj. Gjithashtu një fatkeqësi mund të rezultojë me pamundësinë e ardhjes në punë të punëtorëve për shkaqe të bllokimit të rrugëve.

3.3.2 Kontaminimi i ujit

Kontaminim i ujit konsiderohet çfarëdo materie në cilëndo pjesë të sistemit (pellgun e burimit, ujin nëntokësorë, liqenin akumulues, rezervuar ose sistemin shpërndarës) në sasinë që mund të shkaktojë efekte të dëmshme tek konsumatorët dhe në sistemin e ujësjellësit.

Kontaminimi i ujit të burimit mund të ndodhë si pasojë e zjarrit, përmblytjeve, rrëshqitjes së dheut me ç`rast sasi të mëdha të materialit sedimentues mund të depërtojnë në liqenin akumulues gjë që shkakton ngarkesë të madhe në impiantin e përpunimit të ujit.

Kontaminimi mund të ndodhë edhe si rezultat i shtimit të substancave kimike toksike në liqenin akumulues ose në objektin e kaptimit ose në rezervuar të ujit, që në të shumtën e rasteve vjen si rezultat i derdhjes aksidentale të karburanteve, vajrave, materieve kimike, ose materieve tjera të rrezikshme.

Gjithashtu, kontaminimi mund të ndodh edhe nga erërat e fuqishme që mund t'i bartin papastërtitë në ujë apo kur substancat kimike që përdoren për trajtimin e ujit i shtohen ujit në sasi më të madhe se sa që duhet.

KRU Hidrodrini"Sh.A. do merret me ekipet profesionale bazuar ne rastet e veqanta per te bere

- *kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit të pijshëm;*
